



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:183581

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05521615

C.nr.1656/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Gëzim Shehu, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit J.F. nga fshati Komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës M.A.Sh.-A.A.P.A.Rr. me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguara, vlera e kontestit 3,111.17 (tremijë e njëqind e njëmbëdhjetë euro e shtatëmbëdhjetë cent), jashtë seancës, më datë 28 Mars 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësit J.F. nga fshati Komuna e Suharekës, **DETYROHET** e paditura M.A.Sh.- A.A.P.A.Rr. që paditësit në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 19.08.2018 deri më datë 30.06.2021 apo për 34 muaj (për çdo muaj shumën prej 78.10 euro, në shkallë prej 35 % të pagës bazë - 459 euro, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej **2,655.40 (dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë euro e katërdhjetë cent)**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë me datë 19.08.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumën e gjykuara në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë në shumën prej 455.77 euro, si e pa bazuar.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **144.00 (njëqind e katërdhjetë e katër) euro**, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi J.F. nga fshati Komuna e Suharekës, përmes të autorizuarit të tij av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 19 gusht 2021 ka parashtruar padi kundër të paditurës M.A.Sh.- A.A.P.A.Rr. me seli në Prishtinë, duke theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë shkollës “Qendra e Kompetencës” në Prizren, si mësimdhënës dhe që është i licencuar dhe i kualifikuar me titull master në Informatikën e Biznesit. Meqenëse se paditësi është i licencuar dhe i kualifikuar mësimdhënës me nivelin master në bazë të nenit 7 par.1.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, i është garantuar e drejta në pagesën shtesë prej 35% të pagës bazë, çka e paditura këtë shtesë e paguan pjesërisht dhe jo në tërësi. Nga të lartcekurat paditësi në bazë të kontratës së punës, realizon pagë bazë 442.26 euro, ndërsa shtesën prej 35% e kësaj page apo shuma prej 154.79 euro e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë vetëm 82.55 euro, duke i mbetur borxh shumë prej 72.24 euro. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet padia e paditësit në shumën prej 3,900.96 euro për vitin 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Me parashtresën e datës 18.11.2022, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka bërë precizimin e kërkesëpadiës, duke kërkuar kompensimin në emër të kualifikimit apo licencimit nga data 19.08.2018 deri me datë 30.06.2021, në lartësi prej 35% të pagës neto prej 497.30 euro, për 34 muaj, për secilin muaj nga 91.50 euro, në shumën e përgjithshme prej 3,111.17 euro. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe të njëjtat i ka specifikuar dhe atë për përpilimin e padisë 104 euro, në emër të precizimit të padisë shumë prej 104 euro dhe pagesën e taksës gjyqësore prej 40 euro, gjithsej shumë prej 248.00 euro.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar shumë e kërkuar në emër të kompensimit të diferencës së pagës së kualifikimit, me arsyetimin se paditësi është paguar për çdo muaj për kualifikim nga marrëdhënia e punës, ashtu siç është në listën e pagave. Më tej ka theksuar se kërkesëpadia është në kundërshtim me vetë Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, e cila është shfuqizuar dhe gjithashtu në kundërshtim me Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 e cila gjithashtu nuk është më në fuqi për shkak se MASHT me datën 21.11.2022 është tërhequr dhe si e tillë kjo kontratë nuk mund të gjen zbatim. Kërkesëpadia e paditësit është kërkesë e parashkruar gjegjësisht në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Nga të lartcekurat i propozon gjykatës që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi J.F. është në marrëdhënie pune tek e paditura A.A.P.A.Rr. si mësimdhënës. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të

papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditëses për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata e punës me numër 188/3, të datës 13.10.2017, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, rezulton se paditësi është e punësuar tek e paditura si mësimdhënës. Paditësi ka diplomuar me datë 07.07.2017 dhe ka marr titullin profesional Magjistër në Informatikën e Biznesit dhe ka licencë të karrierës. Nga kërkesa me numër të prot. 659/1, e datës 22.06.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi i është drejtuar të paditurës për kompensimin e gradimit të pa paguar për shkak të licencimit. Nga përgjigjia me numër të prot. 718/1, e datës 24.06.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura e ka refuzuar kërkesën e palës paditëse. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 82.55 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se *“shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që *“për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”*, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë

29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 82.55 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësi përfiton ngritje prej 35% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 160.65 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 78.10 euro apo diferencën e mbetur për 34 muaj (pasi kjo ka qenë kërkesë e paditësit), nga data 19.08.2018 e deri më datë 30.06.2021, në shumë të përgjithshme prej 2,655.40 euro ($34 \times 78.10 = 2,655.40$ euro).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vendosi duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*. Gjukata vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditësit, e që është shuma prej 459.00 euro, dhe jo siç ka kërkuar në petitum të padisë shumën prej 497.30 euro, pasi që kjo është paga neto, ndërsa kompensimi llogaritet vetëm në bazë të pagës bazë. Rrjedhimisht shuma e përgjithshme e refuzuar është në lartësi prej 455.77 euro. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit sikurse në pikën nën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjukata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (19.08.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë

mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit por gjeti se ky pretendim është i pa bazuar për arsye se paditësi ka kërkuar kompensim nga data 19.08.2018 deri me datën 30.06.2021, ndërsa padia është paraqitur me datë 19.08.2021, prandaj nuk ka parashkrim të kërkesës sipas nenit 87 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësit t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 144.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 40.00 euro. Gjkata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar sipas aktvendimit për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
C.nr.1656/21, me datë 28 Mars 2024

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.